


The logo consists of the letters 'A' and 'S' in a stylized, blue, serif font. The 'A' is on the left and the 'S' is on the right, both with a slight shadow effect.The logo features the acronym 'OSCE' in a bold, blue, sans-serif font. Below it, the words 'Mission in Kosovo' are written in a smaller, blue, sans-serif font.

A s s e m b l y S u p p o r t I n i t i a t i v e

Newsletter

Mars 2003, No 05

- 
- A black and white photograph of a woman with short, wavy hair, smiling broadly. She is looking slightly to her right. She is wearing a light-colored jacket and a dark necklace. The background is a plain, light-colored wall.
- Znj. Nafiye Gas, femra e parë në kryesinë e Kuvendit të Kosovës
 - Dr. Alush Gashi kërkon një bashkëpunimin më të mirë me komunitetin ndërkombëtar
 - “Koalicioni Kthimi” të jetë më aktiv në Kuvend
 - Vazhdojnë iniciativat për përkrahjen e Kuvendit

FEMRA E PARË NË KRYESINË E KUVENDIT TË KOSOVËS

Znj. Nafiye Gas, është njëra prej anëtareve të reja të Kuvendit dhe është përfaqësuese e Grupit të komuniteteve tjera në kryesinë e Kuvendit që nga janari 2003. Ajo është kryetare e degës së Partisë Demokratike Turke të Kosovës (PDTK) në Gjilan/Gnjilane. Me profesion është ekonomiste dhe ajo flet rrjedhshëm anglishten, shqipen, serbishten dhe turqishten. "Jam akrep në horoskop, si shumë politikanë të njohur turq" thotë ajo duke buzëqeshur.

Intervista u përgatit nga David Buerstedde dhe Lydia Lecheva

Si ndjeheni si femra e vetme në Kryesinë e Kuvendit?

Z. Nexhat Daci, kryetari i Kuvendit, dhe të gjithë anëtarët e tjerë të Kryesisë më kanë bërë ta ndjej veten shumë mirë. Shumica e kolegëve të mi janë meshkuj. Në fakt, shumica e miqve të mi janë meshkuj, kështu që jam mësuar me ta dhe e ndjej veten fare mirë. Mirëpo, duhet të thuhet se ky është viti im i parë në kryesi (minoritetet joserbe janë të përfaqësuar në kryesi në bazë të rotacionit). Të gjithë kolegët tjerë të mi këtu tanimë kanë një përvojë njëvjeçare. Megjithatë, unë kam një vetëbesim ngase i përfaqësoj edhe interesat e parlamentarëve turqë, boshnjakë, goranë dhe romë, si dhe interesat e femrave parlamentare, dhe brezit më të ri. Por kjo do të thotë që unë duhet njëkohësisht të impenjohem më tepër në emër

të interesit të këtyre grupeve.

Çfarë mendoni për rregullën mbi gjinitë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që ju solli juve dhe femrat tjera në Kuvend?

KQZ ka bërë një punë me mend kur e ka miratuar rregullën që duhet të ketë një femër në çdo tre kandidatë për Kuvendin e Kosovës. U bë sa s'bën më mirë që kësaj rregulle iu përmbajtën edhe gjatë zgjedhjeve lokale. Unë shpresoj që kjo rregullore nuk do të ndryshojë në insitucionet e Kosovës në të ardhmen. Për mua, nuk ka qenë vështirë sepse unë kam përkrahjen e PDTK-së e cila ju ka ofruar mundësi si të rinjëve ashtu edhe femrave.

Për më tepër, unë shpresoj se kjo rregull mbi gjinitë do të fillojë të aplikohet edhe në qeverinë e Kosovës. Bie fjala, ka shumë femra të mençura dhe me përvojë

në Kuvend, por asnjëra nuk u emërua ministre. Por unë do të thoja se ky është problem i partive të tyre. Sidoqoftë, unë mendoj se femrat do të duhej të jenë të përfaqësuar më mirë në postet me përgjegjësi. Femrat duhet të jenë në politikë dhe janë të afta plotësisht që të marrin vendime të drejta.

Si vendosët për vetveten?

Partia ime vuri re se unë mund të merresha me politikë. Askurr nuk më ka shkuar nga mendja që do të ndodhë kjo, por gjithmonë kam pasur mendime politike. Unë i mas gjërat në atë mënyrë. Për shembull, gjatë regjistrimit civil unë konstatova se emri im nuk ishte i shënuar në turqisht. Dhe meqë unë i di të drejtat e mia si pjesëtare e komunitetit minoritar, unë madje i kam mbrojtur ato edhe pa qenë politikanë. Politikani

duhet të dijë një gjë: që të dëgjojë dhe pastaj të bashkëpunojë dhe në këtë mënyrë të jetë i dobishëm për komunitetin e tij apo të saj si dhe për gjithë popullatën e Kosovës, sepse kush respekton veten, pa dyshim do të respektojë edhe të tjerët.

Si do ta inkurajoni përparrimin e të drejtave të femrës?

Unë jam anëtare Grupit të Femrave Udhëheqëse në Kuvend dhe do të bëjë çmos për të inkurajuar femrat që të marrin pjesë aktivisht në jetën publike dhe politike. Afër mendsh, se unë do të përpiqem të jem shembull i mirë për to. Si anëtare e kryesisë së Kuvendit, do të kem mundësi të ngris çështje me interes për femrat në nivelin më të lartë parlamentar. S'dua të jap premtime, por mund të them që dera e zyrës sime është e hapur për të gjitha anëtarët femra të

Kuvendit.

Njëra nga çështjet e para të cilat do t'i shtrojë për diskutim është çështja e arsimit të femrave, sidomos në zonat rurale. Shoqëria jonë nuk mund t'i lejojë vetes që në shekullin XXI të ketë femra të paarsimuar. Përpos kësaj, ne mund të japim sugjerime se si t'i zgjidhim problemet tjera sociale me të cilat ballafaqohen femrat: ato as që do të doja t'i përmend.

"Komunitetet tjera" në Kuvend është një grup parlamentarësh i etnive të ndryshme që përfaqësojnë parti të ndryshme politike të cilat bashkëpunojnë për të përmirësuar statusin e tyre në Kuvend. Si e koordinoni këtë Grup?

Në saje të OSBE-së po punojmë në formimin e "Komuniteteve tjera" si një grup teknik i përkohshëm që bazohet në praktikën



e Parlamentit Evropian në mënyrë që së bashku t'i përfaqësojmë më mirë të gjitha interesat e minoriteteve. Ndërkohë, ne përpigemi të takohemi rregullisht, zakonisht para sesioneve plenare. Kur jam bërë anëtare e kryesisë në janar, "Komunitetet tjera" nuk kishin zyrën e tyre akoma, prandaj unë menjëherë parashtrova

kërkesën për një zyrë. Kështuqë, tani po bëhen përgatitje që zyra e jonë të jetë gati dhe së shpejti "Komunitetet tjera" do të kenë një vend ku do të mund të tubohen. Atëherë edhe koordinimi do të jetë më i lehtë.

Partia e juaj, Partia Demokratike Turke e Kosovës, ishte mjaft e suksesshme

në zgjedhjet lokale 2002. Kolegët tuaj partiak në Prizren tani janë pjesë e qeverisë lokale. Çfarë mund të mësojnë nga partia juaj komunitetet tjera joshumicë?

Që të organizohen me efikasitet më të madh. Duhet mund dhe shumë punë që të arrihet kjo,

por kjo është mënyra e vetme. Koordinimi i mirë i brendshëm dhe mundësia, guximi për të mposhtur apatinë, për të ngritur zërin për problemet dhe për të dhënë propozime konstruktive për ndryshime pozitive, janë të domosdoshme. Kjo është mënyra e vetme për t'i bindur ata që kanë votuar për ju se gjërat mund të ndryshojnë akoma më mirë. Sido që të jetë, inkurajim i veçantë duhet t'u jipet partive të vogla.

Po, PDK ka qenë e suksesshme në zgjedhjet e fundit, por do të bënim më shumë sikur do të kishim pasur një qasje më adekuate në media.

Sipas jush, cilat janë sfida më të mëdha me të cilat ballafaqohen komunitetet minoritare në Kosovë sot?

Komunitetet minoritare mund të jenë vetëm begati për Kosovën. Për shembull, partia ime mund të jetë një urë lidhëse e fortë për bashkëpunim më të mirë me Turqinë, që i nevojitet Kosovës sot më shumë se më parë.

Sfida më e madhe është të krijojmë një atmosferë optimiste në një të ardhme më të mirë. Kjo shumë do të varet nga situata ekonomike. Unë, si ekonomiste, mendoj gjithnjë

se si të përmirësohet ekonomia e Kosovës dhe mundësitë për punësim për të gjitha komunitetet. Kosova nuk mund të përparojë pa një ekonomi efikase. Ne momentalisht jemi duke punuar në shumë projektligje që do ta bëjnë Kosovën më joshëse për investime.

Ju jeni tani figura më e rëndësishme politike për komunitetet turke, boshnjake, gorane, ashkali dhe rome të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës. Ç'keni ndërmend të bëni për ta?

Çfarëdo që është mirë, çdo gjë që është në interesin tonë. Bashkëpunimi me të gjitha partitë politike në Kuvend do të jetë njëra prej çështjeve kyçe. Më thotë mendja se nuk do të jetë e vështirë për mua që ta arrijë këtë sepse partia ime, PDK, është gjithmonë tolerante. Neve, popullatës turke, nuk na pëlqejnë zënkat. Nganjëherë e preferojmë që të mos bëzajmë, por vetëm me qëllim që të arrijmë atë që është për të mirën e të gjithëve.

Znj. Gas, faleminderit për kohën tuaj dhe ju uroj punë të mbarë në veprimtarinë tuaj të ardhshme në Kuvend.

AKTIVITETET E KUVENDIT GJATË KOHËVE TË FUNDIT

Franklin De Vrieze

TRANSFERIMI I MË SHUMË KOM- PETENCAVE NË INSTI- TUCIONET E KOSOVËS

Më 20 janar të vitit 2003 PSSP-ja lu drejtua popullit të Kosovës përmes një interviste të transmetuar në televizion. Ai përmendi ekonominë, krimin dhe multi-etnicitetin si sfida kryesore të Kosovës dhe UNMIK-t në vitin 2003. Ai ritheksoi vullnetin e UNMIK-ut që brenda parametrevë ligjore t'u jep kompetenca më të gjëra institucioneve vendore, ndonse shtoi se bartja e kompetencave varet nga përkushtimi dhe puna e institucioneve të përkohshme. PSSP-ja bëri të qartë se marrëdhëniet me jashtë, lufta kundër kimit të organizuar, siguria dhe të drejtat e minoriteteve, janë kompetenca të rezervuara të cilat tani për tani nuk mund të barten në institucionet vendore. Ai theksoi se do të vijë koha kur statusi i Kosovës do të zgjidhet, megjithëse kjo nuk do të ndodhë në vitin 2003. Duke folur për marrëdhëniet me Beogradin, ai vuri në dukje se bashkëpunimi dhe dialogu me Beogradin u mirëprit dhe se ka dhënë rezultate. Megjithatë, ai tha përzjerja e Beogradit në punët e UNMIK-ut në Kosovë,

nuk do të tolerohet dot. Pas fjalimit të PSSP-së, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Prof. Nexhat Daci, shprehu pak-ënaqësinë e tij me veprimtarinë e PSSP-së. Ai tha se institucionet e Kosovës do të jenë më pak tolerante dhe nuk do t' binden UNMIK-ut si deri më tash, ndërsa viti 2003 do të jetë kthesë ose për të mirën, ose për të keqen e Kosovës. Për t'i shqyrtuar mosmarrëveshjet ndërmjet udhëheqësve vendorë dhe ndërkombëtarë, PSSP-ja mbajti mbledhje të ndara me tre krerët e partive më të mëdha politike shqiptare të Kosovës. Më 27 janar 2003 prof. Daci tha: "Sivjet, ne duhet të bashkëpunojmë më shumë. Institucionet vendore dhe ato të UNMIK-ut duhet të punojnë bashkarisht që t'i zbusin mosmarrëveshjet dhe që të krijojnë një vizion për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës." PSSP-ja tashmë ka kërkuar nga autoritetet e institucioneve të përkohshme që ta njoftojnë me shkrim dhe t'i shfaqin idetë e tyre mbi gjendjen e tanishme për sa i përket bartjes së kompetencave. UNMIK-u gjithashtu është duke shqyrtuar se cilat kompetencë a ligjshmërisht mund t'i besohen popullit të Kosovës deri në fund të këtij viti.

MARRËVESHJA MBI DEKRETIMIN E LIGJEVE

Meqë PSSP-ja nuk i kishte dekretuar ligjet mbi shkollimin e lartë, tregëtinë me jashtë dhe telekomunikimin (shih buletinin e mëparshëm informativ të IMK-së - f. 5), më 13 shkurt 2003 prof. Daci ia dërgoi PSSP-së një letër ku ishin përfshirë katër propozime mbi zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me aprovimin e ligjeve të miratuara në Kuvend nga UNMIK-u.

++ Së pari, Zyra e këshilltarit juridik të UNMIK-ut duhet t'ia dërgojë vërtetjet e tij mbi ligjet e propozuara Zyrës së kryeministrit, në rastet kur ekziston mundësia që këto ligje të bien ndesh me Kornizën Kushtetuese, para se ato të dorëzohen në Kuvend.

++ Së dyti, Zyra ligjore e UNMIK-ut duhet t'ua bashkangjesë ligjeve të refuzuara një deklaratë, në të cilën duhet të jipen shpjegime të hollësishme mbi mospërputhjen e ligjeve të miratuara nga Kuvendi me Kornizën Kushtetuese dhe mbi mënyrën se si duhet të përmirësohen ato.

++ Së treti, qeveria ka ngritur disa çështje që kanë të bëjnë me aprovimin e ligjeve të propozuara, tok me një numër amendamentesh për të cilët

ekzekutivi as nuk është vënë në dijeni, as që është konsultuar më parë. Kryesia e Kuvendit ka aprovuar disa udhëzime shtesë mbi procedurat që kanë për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit dhe që duhet të zbatohen në të ardhmen kur Kuvendi të debatojë mbi ligjet e propozuara. Nga ministrat kërkohet që të marrin pjesë në diskutimet e fillimit mbi projektligjet që propozohen nga komisionet e Kuvendit. Deputetët që propozojnë shtimin e paragrafeve të reja në ligje lypset ta informojnë komisionin, në mënyrë që këto ndryshime t'i kthehen ministrat për shqyrtim. Qeveria do të kërkojë nga komisionet që t'i japin mendimet e tyre, që do të regjistrohen. Gjatë shqyrtimit të dytë të në Kuvend, kryetari do të konsultohet me ministrin dhe me komisionet tjera përkatëse.

++ Së katërti, ligjet që PSSP-ja refuzon t'i nënshkruajë dhe ia kthen Kuvendit. Sipas Kornizës Kushtetuese, asnjë ligj nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Prandaj, PSSP-së iu propozua formimi i një grupi të punës nga radhët e komisioneve përkatëse, që do të përbëhej nga ministrat në fjalë dhe zyrtarët ligjorë të UNMIK-ut. Grupi punues do ta shqyrtonte mospërputhjen e projektligjeve

me Kornizën Kushtetuese dhe do të përipiqej që të arrinte marrëveshje me konsensus mbi tekstet e ligjeve të sapo propozuara, që më pas do të parashtraheshin në Kuvend si ligje të reja të propozuara.

PSSP-ja ra dakord me katër propozimet e profesor Dacit. Pritet që grupet e punës së shpejti do ta fillojnë punën e tyre.

"KOALICIONI KTHIMI" KTHEHET NË KUVEND

Zsha. Rada Trajković, më 30 dhjetor 2002, kryesuesja e grupit parlamentar të "Koalicionit Kthimi" (KP-së) në Kuvend, dha dorëheqje. Ajo u zëvendësua nga Prof. Dragisa Krstović, jurist, ish gjykatës nga Leposaviqi dhe anëtar i Partisë Demokratike të udhëhequr nga kryeministri serb Zoran Gjinjiq. (shih intervistën me Z. Krstović në këtë buletin). Pas tre muajsh bojkoti, kah mesi i muajit shkurt, KP-ja përsëri mori pjesë në sesionet plenare të Kuvendit. Me këtë rast, Prof. Daci, kryetari i Kuvendit të Kosovës, "u dëshiroi mirëseardhje të ngrohtë" deputetëve të KP-së. Ndërsa, Prof. Krstović sqaroi "se sa e vështirë kishte qenë për KP-në për të marrë një vendim të tillë" dhe njëherësh bëri thirrje për "ruajtjen e një atmosfere tolerante në Kuvend."

DEKLARATË E PËRBASHKËT E KATËR GRUPEVE PARLAMENTARE MBI DEKLARATËN E PAVARËSISË

Më 4 shkurt 2003 Parlamenti Federativ në Beograd shpalli një

Kartë Kushtetuese me të cilën themeloi shtetin e ri të quajtur "Serbia dhe Mali i Zi." Meqë në preambulën e kësaj Karte Kushtetuese përmendet Kosova, një grup i deputetëve të Kuvendit të Kosovës filloi t'i mbledhë nënshkrimet për të përfshirë miratimin e Deklaratës për pavarësinë e Kosovës në procedimet e Kuvendit. Z. Bujar Dugolli, shef i grupit parlamentar të AAK, vuri në dijeni Kuvendin për mbështetjen e 42 deputetëve për këtë nismë. Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dënuan ashpër nismën për pavarësi. Edhe PSSP-ja, BE-ja dhe Zyra Amerikane, kundërshtuan fuqimisht këtë iniciativë, meqë konstatuan se kjo është jashta kompetencave të Kuvendit, përderisa zyrtarët e lartë të LDK-së dhe të PDK-së diskutuan rreth asaj "se a ishte momenti i përshtatshëm për shpalljen e pavarësisë."

Me 13 shkurt 2003 Kuvendi i Kosovës u mbledh në një sesion plenar. Edhe pse Deklarata mbi pavarësinë nuk ishte futur më parë në rendin e ditës, një anëtar i kryesisë së Kuvendit, lexoi një Deklaratë të përbashkët të liderëve të katër grupeve politike - grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së), grupit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-së) dhe atij të komuniteteve tjera (KT-së - minoriteteve joserbe) - mbi Deklaratën. Në këtë Deklaratë të përbashkët, liderët shprehën përkrahjen e tyre për iniciativën për aprovimin e Deklaratës për pavarësi dhe ranë dakord që ta rishqyrtojnë tek-

stin e pastaj në ndonjërin nga sesionet e ardhshme ta parashtrajnë për aprovim Deklaratën e "harmonizuar" për pavarësi. Meqë nuk u diskutua më tutje rreth Deklaratës së propozuar për pavarësi, Kuvendi vazhdoi me shqyrtimin e projektligjeve.

KRYESUESI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PDK-SË U AKUZUA NGA TRIBUNALI I HAGËS

Katër ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) janë akuzuar nga Tribunali Ndërkombëtar mbi Krimet në ish-Jugosllavi (TNKJ-ja) për krime lufte të kryera në territorin e Kosovës ndërmjet muajve maj dhe korrik të vitit 1998. Tre nga të akuzuarit kryesorë u arrestuan nga KFOR-i në Kosovë më 17 shkurt. I akuzuari i katërt, Fatmir Limaj, ndodhej në Slloveni, kur u informua për akuzën dhe shprehu gatishmërinë e tij për t'u dorëzuar vullnetarisht, ndërsa nga qytetarët kërkoi që ta ruajnë qetësinë dhe t'u shmangen demonstratave. Z. Limaj është deputet i Kuvendit të Kosovës dhe shef i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së).

Të katër të pandehurit janë në arrest për krime lufte të bëra kinse gjatë kohës kur ata kishin qenë në shërbim të UÇK-së në burgun e Llapushnikut, në komunën e Gillogovcit. Z. Fatmir Limaj gjatë kësaj kohe ishte komandant në radhët e UÇK-së dhe pohohet se ka qenë përgjegjës

për operacionet në burgun e Llapushnikut. Në akuzë thuhet se gjatë vitit 1998 të katër të akuzuarit kanë bërë, apo përdryshe kanë marrë pjesë dhe kanë nxitur krime duke burgosur, keqtrajtuar dhe vrarë si civilë serbë ashtu dhe shqiptarë. Këto janë arrestimet e para të shqiptarëve të Kosovës në territorin e Kosovës pas një akuze nga ICTY (TNKJ-ja). Akuzimi i shefit të grupit parlamentar të PDK-së pati si rrjedhojë ndërprerjen e sesionit të rregullt plenar të Kuvendit më 20 shkurt 2003. PSSP-ja Steiner tha se qëndrimi i insitucioneve të Kosovës për t'i respektuar procedurat ligjore të Tribunalit duhet të jetë shembull për tërë rajonin.

PROÇESET LEGJISLATIVE NË JANAR DHE SHKURT TË VITIT 2003

Më muajt e parë të vitit 2003, Kuvendi, pas shqyrtimit të dytë, miratoi tri ligje: ligjin mbi Mbrojtjen e Ambientit (shih artikullin në këtë buletin), ligjin mbi Pyjet dhe ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi aprovoi në parim (pas shqyrtimit të parë) ligjin për Farërat, ligjin mbi Likuidimin e Borxheve dhe Falimentimin.

UDHËHEQËSIA E RE E "KOMUNITETEVE TJERA" NË KUVEND

Anëtarët e "Komuniteteve tjera" në Kuvend zgjodhën udhëheqë-

sit e ri të grupit me 20 shkurt 2003. Parlamentarët turqë, boshnjakë, goranë, ashkali dhe romë emëruan z. Faik Marollin (ashkali nga PDASHK) udhëheqës dhe z. Sadik Idrizin (boshnjak nga VATAN-i) si zëvendës të tij. Ekziston një marrëveshje në mes të parlamentarëve jo serb sipas së cilës secili do ta merrë udhëheqësinë me mandat njëvjeçar në bazë të rotacionit. Këtë vit, është radha e ashkalinjëve/romëve që ta udhëheqin grupin.

Z. Zylfi Merxha, përfaqësues rom (PREBK) njoftoi se po largohet nga grupi dhe se meqë nuk ishte zgjedhur udhëheqës në të ardhmen do të veprojë në mënyrë të pavarur. "Komunitetet tjera" tani përbëhet nga 9 anëtarë.



Prof. Daci, Kryetar i Kuvendit (LDK) dhe Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë (PDK), njoftojnë për shtyrjen e sesionit të rregullt plenar të Kuvendit me 20 shkurt 2003, pas padisë së ngritur nga ana e Tribunalit të Hagës (ICTY) kundër Fatmir Limës, kryetar i grupit parlamentar të PDK-së.

“EKZISTON NEVOJA PËR NJË BASHKËPUNIM MË TË NGUSHTË NË MES TË KUVENDIT DHE PSSP-SË”

Kohë më parë profesor Alush Gashi u emërua si zëvendës kryesues i ri i grupit parlamentar të LDK-së. Me këtë rast, me një ton miqësor po edhe të fuqishëm ai e komunikoi mesazhin e tij kryesor: është e nevojshme që të krijohet një mekanizëm i ri që do t'u bënte të mundur institucioneve kosovare të angazhohen “për ditë” me administratën e KB.

Intervistën e përgatiti Mustafa Eriç, OSBE.

Profesor Alush Gashi është i vetëdijshëm se PSSP përfaqëson në Kosovë Këshillin e Sigurimit të KB. Ai poashtu, e ka të qartë se PSSP-ja e përfaqëson Kosovën në botë dhe merr vendime në emër të gjithë Kosovës. “Për këtë arsye, unë besoj se përfaqësuesit e zgjedhur duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij procesi. Unë nuk shoh ndonjë arsye pse të mos marrin pjesë përfaqësuesit vendorë në të gjitha mbledhjet e tij, mbi marrëdhëniet ndërkombëtare ose sigurinë apo edhe me çdo kompetencash të rezervuara, në mënyrë që të mund të mësojnë, por njëherësh edhe të dëshmojnë punën e tyre”, tha z. Gashi.

Ai insistoi se duhet të ketë mekanizma për bashkëpunim të rregullt në mes të institucioneve kosovare dhe Zyrës së PSSP, duke shtuar se, “mungesa e mekanizmave të tilla shkakton probleme.” Për shembull, është e “papranueshme” që ligjet e miratuara nga Kuvendi të presin dy muaj për t'u nënshkruar nga PSSP. “Kjo është e papranueshme për mua,” tha Gashi. Ai shtoi se “duhet të



ekzistojë një ko-ordinim më i mirë, i cili duhet të bëhet përmes një mekanizmi të bashkëpunimit dhe komunikimit të përditshëm dhe të përgjegjshëm, në mes të qeverisë së Kosovës, kryesisht së Parlamentit, kryetarit të Kosovës dhe Zyrës së PSSP.”

“Një anëtarë i Parlamentit është paditur dhe kjo nuk është një ngjarje e vogël,” tha z. Gashi duke iu referuar padisë së ngritur kundër z. Limajt nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi. “Ne duhet

këtë ta bëntë një shtet tjetër. Së këndejmi, përfshirja e zyrtarëve të zgjedhur të Kosovës në veprimtarinë e PSSP-së është e nevojshme jo vetëm për të dëshmuar respektin për institucionet vendore, por për të siguruar me të vërtetë zbatimin e asaj që është premtuar me rezolutën 1244.”

Sa i takon transferit të kompetencave nga UNMIK-u te institucionet e Kosovës, ai theksoi se zyrtarët e zgjedhur kosovarë do të duhet të bashkëpunojnë me zyrën e PSSP-së e jo si “institucione paralele.” Z. Gashi shprehu bindjen e tij të thellë se PSSP-ja “do ta hapë derën për ne dhe për atë proces,” duke pranuar poashtu se KFOR-i do të mbetet në këtë rajon për një kohë për shkak të situatës së “nderë” në rajon.

I pyetur për pikëpamjen e tij mbi deklaratën e propozuar për pavarësi, z. Gashi përkujtoi se popullata e Kosovës ka përkrahur tanimë një Kosovë demokratike, të lirë dhe të pavarur në referendumin e vitit 1991. Ai tha se debati mbi çështjen e pavarësisë ka

dëshmuar se ekziston një bashkëpunim shumë i mirë ndërmjet partive të mëdha politike në Kuvendin e Kosovës dhe se liderët e grupeve parlamentare i kanë dorëzuar së bashku një propozim kryesisht të Kuvendit. “Kjo do të bëhet atëherë kur udhëheqësit do të besojnë se është koha e volitshme” shtoi ai.

Sa i përket kontributit të komuniteteve tjera në ndërtimin e politikës, z. Gashi vuri në dukje që shumica është e hapur për të rrahur të gjitha propozimet, “sepse ne kemi përkrahur nenin e Kornizës Kushtetuese sipas të cilit të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë. Ne besojmë se përfaqësuesit serb sapo të fillojnë të konsiderojnë Kosovën e jo Beogradin si qendër të vendim-marrjes, tensionet të cilat ekzistojnë do të shtendosen.”

Ai vuri në dukje se Kuvendi nuk ka miratuar asnjë ligj, me anë të cilit do të rrezikonte pozitën e komunitetit serb në Kosovë. “Njëherësh, ne duhet të bëjmë çmos që demokracia të funksionojë në Parlament, duhet të marrim vendime dhe në fund janë votat që vendosin. Unë besoj se të gjithë në parlament duhet ta pranojnë mekanizmin kryesor të vendim-marrjes, votën”, theksoi z. Gashi. “Në të njëjtën kohë, ne kemi vendosur për të vazhduar respektimin e sundimit të ligjit dhe procedurat e miratuara të Parlamentit”

I pyetur për tensionet në mes të partive të ndryshme shqiptare, z. Gashi tha:

"Parlamenti ka kontribuar në bashkimin e partive të ndryshme politike. LDK, PDK dhe AAK punojnë çdo ditë së bashku në komisione dhe në kryesi të Parlamentit. Ne takohemi si krerë të grupeve parlamentare, edhe në debatet shumë të rëndësishme për Kosovën. Për fat, të gjitha partitë politike pajtohen. Unë besoj se bashkëpunimi konstruktiv në Parlamentin e Kosovës do të vazhdojë. Nuk mund të lejojmë që të grindemi me njëri tjetrin, përkundrazi ne duhet të bashkëpunojmë më shoqi shoin."

Kur është fjala për situatën në mes të degëve vendore të partive politike, z. Gashi tha se mesazhi i kryetarit Rugova ishte i zëshëm dhe i qartë: "Puna jonë duhet të jetë demokratike, dhe transparente, sepse duhet të mbizotërojë bashkëpunimi dhe jo konfrontimi. Kjo vlen si për vendorët ashtu edhe për ndërkombëtarët."

I pyetur për agjendën e ardhshme legislative, veçanërisht për projektligjet mbi çështjet e mirëqenies sociale dhe të shëndetësisë, z. Gashi përkujtoi se në situatën post-konfliktuale ka pasur një shkallë të lartë papunësie dhe një nevojë për një mbulim gjithëpërfshirës të shtresave të ndryshme të popullatës në sektorët e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Mirëpo, ai nënvizoi se ata e shohin të udhës përfshirjen e sektorit privat dhe konkurrencën në sektorin shëndetësor në shërbimet shëndetësore publike.

SFIDAT E LIGJIT PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT

Më 16 janar 2003 Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës. Ligji për Mbrojtjen e Ambientit (LMA) është miratuar pas aprovimit të tetëdhjetë amendamenteve tjera. LMA-ja ishte një kompromis midis atyre të cilët dëshirojnë të kenë një ambient të pastër dhe atyre të cilët dëshirojnë të kenë zhvillim të përshpejtuar ekonomik duke përdorur burimet natyrore.

Blerim Vela, Menaxher i Informimit në Qendrën Regjionale të Mjedisit për Evropën Qëndrore dhe Lindore në Kosovë.

Dikush mund ta 'interpretojë' këtë si 'eliminimin e pengesave që kanë të bëjnë me "ruajtjen e mjedisit" për të mundësuar zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës'. Por kjo çështje nuk është ngritur ashtu si duhet. Qytetarët e Kosovës duhet të kenë një ambient më të sigurt dhe më të shëndoshë krahas zhvillimit ekonomik. Kjo, në fakt, nënkupton një zhvillim konstant - duke i shfrytëzuar burimet natyrore deri në atë masë që të të rrezikohet e ardhmja e brezave të ri.

Shqyrtimi i parë i ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në Kuvendin e Kosovës është bërë në muajin tetor të vitit 2002. Sponsori i LMA-së, Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor, sqaroi se ky ligj i përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e ambientit në Kosovë, duke i përfshirë burimet natyrore siç janë uji, ajri, toka dhe biodiversiteti. Përveç kësaj, ky ligj përcakton themelimin e Agjencionit Kosovar për Mbrojtjen e Ambientit si dhe Fondin Kosovar për Ambientin.

Qëllimi i LMA-së është që të krijojë një kornizë ligjore bazë, e cila do të sigurojë një mjedis përherë e më të shëndoshë përmes njohjes graduale me standardet e mje-

disit të Unionit Evropian. Ky ligj gjithashtu do të krijojë një kompetencë të veçantë dhe do të përcaktojë qartë obligimet e autoriteteve përgjegjëse civile për njohjen graduale dhe zbatimin e këtyre standardeve. Ky ligj përcakton në përgjithësi parimet kryesore të politikës së mjedisit në Kosovë, përfshirë këtu edhe parimin e prodhimit dhe riciklimit të pastër, si dhe parimin sipas të cilit edhe ndotësit edhe shfrytëzuesit duhet të kenë përgjegjësi.

Megjithëse është hera e parë që Kosova në legjislaionin e vet ka një ligj për Mbrojtjen e Ambientit, ligji përmban plot paqartësi dhe le mundësinë për interpretime të shumta. Për shembull, neni 13 (Miratimi dhe Ndalimi i Importit) paragrafi 4 thotë: "Ministria mund të hedh çdo mall të importuar, eksportuar, magazinuar ose transportuar në mënyrë të paligjshme apo edhe ato mallëra të cilat konsiderohen se janë në kundërshtim me këtë nen". Megjithatë, aty nuk përcaktohet qartë se kush do të mbulojë shpenzimet e këtyre veprimeve, ku do të hedhen ato dhe në çfarë afati kohor do të hedhen.

Sot, problemet e mjedisit në Kosovë janë akute, dhe përfshi-

jnë: bërlogun në zonat e banuara; ndotjen e ajrit nga djegëja e mbeturinave, thëngjillit, dhe drurit të lagur; metalet e rënda në ujën e pijshëm si rezultat i mos kontrollimit të gropave të minierave dhe industrisë së rëndë; shpyllëzimin e shpative të malit; dhe depot të mbushura të pashfrytëzuara. Një kërcënim shumë të madh për shëndetin e popullatës dhe për mjedisin paraqet më parë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), furnizuesi kryesor i energjisë elektrike për ekonomitë familjare dhe industrinë, pastaj hapja e fabrikave (uzinave) të mëparshme industriale të "Trepçës" dhe "Ferronikelit". Gjatë rindërtimit dhe privatizimit të tyre duhet të merren parasysh edhe çështjet e ambientit. Implementimi i këtij ligji duhet t'u sigurojë qytetarëve një ambient më të shëndoshë dhe më të sigurt.

Nëse LMA-ja është shpallur nga Përfaqësuesi Special i UNMIK-ut, atëherë OJQ-të të cilat merren me çështjet e mjedisit duhet të punojnë shumë për të luajtur një rol aktiv dhe të rëndësishëm në zhvillimin (implementimin) e mëtejshëm të këtij ligji. Përdorimi i informatave dhe i ligjit, parime këto të Konventës Aarhus

që janë përfshirë në këtë ligj, paraqesin përpjekje të cilat do të kontribuojnë në demokratizimin e shoqërisë së Kosovës. Këto parime të 'demokracisë së mjedisit' duhet të fuqizohen dhe të vihen në jetë në mënyrë që qytetarët e Kosovës të kenë të drejtë që të informohen rreth gjendjes së mjedisit, degradimit të ambientit dhe kërcënimeve ndaj shëndetit të popullatës, por njëherësh të kenë të drejtë të parashtrojnë ankesa nëse paraqitet nevoja. Lidhur me këtë çështje, OJQ-të vendore të cilat merren me çështjet e mjedisit duhet të përfshihen në mënyrë më aktive në zgjidhjen e problemeve aktuale të mjedisit.

Qendra Regjionale e Mjedisit për Evropën Qëndrore dhe Lindore (QRM) është organizatë neutrale, që nuk ofron mbrojtje ligjore dhe është joprofitabile. Ajo është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Hungaria. Zyra e saj në Kosovë është hapur në muajin qershor të vitit 2000. Misioni i saj është të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të mjedisit në Rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore (EQL) dhe të inkurajojë progresin e tij drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Intervistë me z. Dragisa Krstovic, Shef i Grupit Parlamentar të Koalicionit Kthimi (KP-së).

“DO TË MARRIM PJESË MË AKTIVISHT NË PUNËN E KUVENDIT”

Dragisa Krstovic u zgjodh deputet i “Koalicionit Kthimi” në Kuvendin e Kosovës në vitin 2001.” Kohë më parë ai u emërua shef i këtij grupi parlamentar. Gjatë pjesës më të madhe të karrierës së tij ai punoi si gjykatës dhe tani jeton në Leposaviq.

Intervistën e përgatiti Jonathan Browning, Zyrtar i Demokratizimit i OSBE-së në Leposaviq

Z. Krstovic falemnderit që keni gjetur kohë për të diskutuar me ne lidhur me idetë tuaja mbi punën e Kuvendit të Kosovës. Në dhjetor të vitit të kaluar ju u zgjodhët shef i ri i grupit parlamentar të KP-së. Çfarë mund të na thuani lidhur me postin tuaj të ri?

Nuk është lehtë të jesh shef i grupit parlamentar të KP-së. Ka shumë përgjegjësi. Por, mendoj se do të jem në gjendje që ta kryej këtë detyrë si duhet dhe ti përmbushi kërkesat e të gjithë deputetëve të grupit parlamentar të KP-së, përfshirë edhe vullnetin e popullit që ne e përfaqësojmë. Në të ardhmen e afërt do të jemi të detyruar që të marrim vendime të rëndësishme, do të ballafaqohemi me çështje për të cilat do të ketë nevojë të diskutohen, dhe me çështje që janë të ndjeshme. Veç kësaj, është me rëndësi që KP-ja të marrë qëndrim të drejtë ndaj këtyre vendimeve dhe të diskutojë mbi to si brenda KP-së, ashtu edhe në kuadër të vetë Kuvendit.

Çfarë shpresoni ju dhe KP-ja në tërësi që të arrini në të

ardhmen e afërt me ligjet që do të miratohen. Për shembull, me ligjet që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike, të bujqësisë dhe me ato sociale?

Unë shpresoj se në të ardhmen e afërt Kuvendi i Kosovës prioritet do t'u japë miratimit të ligjeve, duke pasur parasysh pikëpamjet e të gjitha komuniteteve. Njëherësh, shpresoj se Kuvendi nuk do të merret me çështjet për të cilat nuk ka autorizime, për shembull, me çështjet siç janë sovraniteti dhe pavarësia e Kosovës, sepse me atë rast ne do provokoheshim dhe do të reagonim. Sa i përket veprimtarive legjislative, unë shpresoj se Kuvendi do të miratojë ligje të përgatitura mirë, që do të krijonin një kornizë ligjore për të gjitha fushat që duhet të rregullohen me ligj. Këtu do të përfshiheshin ligjet mbi tatimet, mbi çështjet sociale dhe të gjitha çështjet tjera që drejtëpërsëdrejti ndikojnë në jetën e çdo qytetari të Kosovës. Mendoj se deputetët e Kuvendit do ta kenë mundësinë që të hartojnë ligje të cilat do t'i përmbushnin nevojat e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe që



do të zbatoheshin në mënyrën më të mirë.

Çfarë do të ndërmerri në mënyrë që idetë dhe propozimet tuaja të miratohen në Kuvend? Si mendoni t'i sëndërtoni synimet tuaja?

Ne do të kemi një qasje tjetër nga ajo që e kemi pasur deri më tani. Së pari, do të marrim

nevojshme me rastin e marrjes së vendimeve për ligjet, amendamentet dhe aspektet tjera të punës sonë. E tërë kjo do ta ketë për qëllim ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve. Së dyti, do të përpiqemi që në kuadër të KP-së të formulojmë dhe propozojmë amendamente. Meqë nuk jemi të sigurtë se shumica e propozimeve tona do të pranohen, ne do të përpiqemi që këto propozime t'i mbështesim me argumente të qarta, të përgatitura paraprakisht, në mënyrë që propozimet tona të jenë më të qëlluarat dhe më të mirat. Se sa do të jemi të suksesshëm mbetet për t'u parë, por ne do të bëjmë çmos për të qenë sa më të suksesshëm. Nuk është mirë që në grupet punuese të qeverisë, të cilat punojnë në hartimit e ligjeve, të mos përfshihen përfaqësuesit serbë. Po të kishim qenë të angazhuar në këto grupe që në fillim, serbët do ta kishin pasur më shumë ndikim në procesin e hartimit të ligjeve. Megjithatë, më duhet të them se kurdo që konstatojmë se janë rrezikuar interesat e komunitetit tonë, ne do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet dhe mekanizmat e paraparë me Kornizën Kushtetuese që t'i mbrojmë ato. Njëri nga këta mekanizma është edhe e drejta jonë për ta kundërshtuar ndonjë ligj, nëse ka nevojë. Së pari, ky kundërshtim do t'i parashtrohet kryesisht së Kuvendit. Nëse kryesia e Kuvendit nuk mund të gjejë ndonjë zgjid-

pjesë më aktivisht në veprimtarinë e komisioneve të Kuvendit. Do të përpiqemi që t'i arrijmë disa marrëveshje për të cilat mendojmë se janë të mira dhe të dobishme. Jemi duke e themeluar një shërbim ligjor në kuadër të KP-së që do të përbëhet nga disa ekspertë ligjorë. Ata do të na ofrojnë ndihmë dhe këshilla që janë të

hje, atëherë do të formohet një panel i posaçëm nga PSSP-ja. Duke shfrytëzuar një mekanizëm të tillë, ne do të mund të përpiqeshim që t'i menjajmë gjërat të cilat i cenojnë interesat e komunitetit tonë nga ligjet e miraturot në Kuvend.

Si i shihni marrëdhëniet tuaja me partitë dhe subjektet tjera politike në Kuvendin e Kosovës?

Marrëdhëniet tona me subjektet tjera politike nuk janë aspak më të mira se sa kishin qenë kur patëm braktisur Kuvendin, madje mendoj se ndoshta janë përkeqësuar edhe më. Kjo ndodhë për shkak se po shtrohen disa çështje që nuk janë paraparë për diskutim në Kuvend dhe për shkak se deputetët po bisedojnë lidhur me to përkundër faktit se ato nuk futen në rendin e ditës. Kjo është në kundërshtim me procedurat e Kuvendit, me Kornizën Kushtetuese dhe me dokumentet tjera ligjore. KP-ja është mjaft e shqetësuar për këtë dhe ne jemi të detyruar që seriozisht dhe racionalisht të përkujdesim për rolin që KP-ja e luan në Kuvend. Pas kthimit tonë në Kuvend më 13 shkurt 2003, në sesionin e parë të Kuvendit, KP-ja u gjet në një situatë të palakmueshme. E kishim shumë të vështirë që të vendosim nëse do të qëndronim edhe më tej, apo nëse do ta braktisnim sesionin. Sesioni që ishte caktuar për 20 shkurt nuk u mbajt ngase

deputetët shqiptarë të Kosovës ishin të shqetësuar për shkak të akuzimeve nga Tribunali i Hagës. Kjo ishte arsyeja pse ne e kishim të vështirë që të vendosim nëse do të hynim në sallën e Kuvendit për ta formuar kourumin apo jo. Unë mendoj se edhe në të ardhmen, gjatë çdo sesioni të Kuvendit, ne do të hasim në vështirësi të tilla, çfarë do ta vë në dyshim nevojën reale të KP-së për të qenë pjesë e këtij Kuvendi.

Atëherë, meqë tani ju është dëshiruar mirëseardhje pas kthimit tuaj në Kuvend, çfarë do të dëshironit t'u thoshit kolegëve tuaj deputetë për punën që ju pret në të ardhmen?

Kolegëve të mi deputetë do të dëshiroja t'u dërgoj këtë mesazh. Ti lëmë anash dhe të mos diskutojmë për çështje që nuk i përkasin Kuvendit dhe të cilat, sipas Kornizës Kushtetuese, nuk mund të përfshihen në rendin e ditës. Le të fillojmë të merremi me punë të dobishme, si me miratimin e ligjeve dhe me krijimin e një kornize ligjore që do na e mundësonte të punojmë drejt një të ardhme më të mirë. Duhet të bëjmë diçka lidhur me kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit, duhet të punojmë për një jetë më të sigurtë dhe më të mirë për të gjithë banorët e Kosovës, krahas shumë çështjeve tjera që janë me rëndësi kryesore për njerëzit që jetojnë në Kosovë.

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG DHE KUVENDI NË VITIN 2003

Besa Luzha, Koordinator e programit të FES-it për Kosovë.

Duke pasë parasysh faktin se puna parlamentare ka shënuar një përparim sa i takon respektimit të rregullave dhe procedurave, Friedrich Ebert Stiftung (FES) planifikon që ta vazhdojë përkrahjen për çështje të ngjashme, duke u përqëndruar më tepër në çështjet që kanë të bëjnë me këshillimet. Ne do të përqëndrohemi rreth komisioneve të njëjta të Kuvendit me të cilat kemi punuar edhe vitin e shkuar. Ato janë komisioni për Punë dhe Çështje Sociale, komisioni për Shërbime Publike, komisioni për Ambient dhe Planifikim Hapësiror, por ne do t'i përfshijmë edhe komisionet tjera për të diskutuar rreth temave dhe çështjeve të cilat kanë të bëjnë me këto tri komisione kryesore.

Trajnimi mbi metodat e hulumtimeve dhe mbledhjes së të dhënave për nevojat e komisioneve, i planifikuar të mbahet kah fundi i shkurtit, do t'ju ndihmojë anëtarëve të komisioneve që të kenë përvojë dhe informata më të shumta në mënyrë që të njihen më mirë me ligjet që do të duhet t'i rishqyrtojnë, diskutojnë dhe përmirësojnë.

Një nga aktivitetet që është propozuar për të ardhmen është edhe programi internship, ku studentët e suksesshëm të Universitetit të Prishtinës do t'ju ndihmojnë parlamatrive-individualisht, brenda komisioneve dhe në grupe.

Një formë tjetër e përkrahjes të aktiviteteve parlamentare do të jetë promovimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit midis Parlamentit dhe faktorëve tjerë të shoqërisë civile, siç janë OJQ-të, komunitetet lokale dhe organizatat e të rinjve, përmes debateve, trajnimeve dhe seminareve. Ky është një kontribut mjaft i rëndësishëm për të siguruar një proces më të mirë dhe të mirëfillt legjislativ në përgjithësi dhe që do të përfshinte kontributet e grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Njëherësh, shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi rajonal poashtu, do të jenë në qendër të vëmendjes gjatë bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve tona me partnerët tanë të ASI-së. Ky bashkëpunim i frytshëm rajonal në mes të Kuvendit të Kosovës dhe parlamenteve të rajonit do të vazhdojë të

përqëndrohet në çështjet e përbashkëta dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e komisioneve në përgjithësi dhe të deputetëve, në veçanti. Fillimisht është paraparë një vizitë në Shqipëri në mars të këtij viti, më pas një vizitë Parlamentit Kroat.

Meqë stafin e Parlamentit e konsiderojmë si faktor me ndikim dhe shumë të rëndësishëm në avansimin e punës profesionale, ne do të vazhdojmë t'i përkrahim ata duke organizuar trajnime të ndryshme gjatë muajve mars dhe prill, u muar vesh duke marrë parasysh vlerësimet e tyre për nevojat dhe problemet me të cilët ballafaqohen ata dhe deputetët. Përpos kësaj, ne kemi planifikuar edhe nxjerrjen e një broshure udhëzuese mbi punën parlamentare, e cila do të mundësojë që të kuptohet më mirë dhe më lehtë puna e komisioneve, por edhe një bashkëpunim më të frytshëm me komisionet dhe organet tjera të Parlamentit. Të gjitha këto forma të bashkëpunimit do të përgatiten në bashkëpunim të ngushtë me vetë deputetët, grupin ASI dhe partnerët tjerë të involvuar.

KUVENDI ANALIZON DHE DEBATON MBI RREZIQET E SIGURISË

Më 23 janar 2003 Kuvendi i Kosovës e vlerësoi situatën e sigurisë në Kosovë. Z. Jean-Christian Cady, Zëvendës i Përfaqësuesit Special për Polici dhe Drejtësi i Shtyllës 1 të UNMIK-ut, si dhe Komisari i Policisë, Stefan Feller, i paraqitën vlerësimet e tyre. Pas një debati të hollësishëm Kuvendi miratoi një deklaratë kundër dhunës. Më pas, Z. Cady-it e paraqiti raportin mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë për periudhën nga tetori i vitit 2002 deri më janar të vitit 2003 si dhe mbi deklaratën e miratuar nga Kuvendi.

Statistikat e krimit për vitin 2002 tregojnë një progres drejt stabilizimit dhe normalizimit të gjendjes së sigurisë. Kështu, shkalla e vrasjeve në vitin 2002 ka rënë për 61% krahasuar me vitin 2001. Numri i kidnapimeve ka rënë për 51%. Numri i plaçkitjeve ka rënë për 10%. Numri i krimeve ndëretnike është duke shënuar rënie. Njëherësh, edhe shkalla e zbulimit të krimeve prej 53% është mjaft inkurajuese dhe është më e lartë se në shumicën e shteteve perendimore.

Një nga arsyt kryesore të këtij progresi është numri më i madh dhe prania gjithnjë e më e madhe e pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së) në rrugë - 5200 në janar të vitit 2003, krahasuar me 4300 në dhjetor të vitit 2001 - si dhe kompetencat e shtuara të pjesëtarëve të policisë së Kosovës. Një ngjarje tjetër me rëndësi është vendosja e pushtetit të UNMIK-ut në pjesën veriore të Kosovës, shpërndarja e strukturave paralele policore dhe juridike që ishin duke funksionuar në këtë pjesë si dhe dislokimi i SHPK-së në këtë zonë.

Krijimi i policisë shumetnike

SHPK-ja është forcë policore shumetnike që përbëhet nga 84% shqiptarë të Kosovës, 9% serbë të Kosovës dhe 7% pjesëtar të komuniteteve të tjera. Policia e UNMIK-ut, bashkë me SHPK-në, janë të pranishme në mbarë Kosovën. Në pjesën veriore të Kosovës janë duke u angazhuar gjithnjë e më shumë pjesëtarë të SHPK-së nga rradhët e të gjitha komuniteteve.

Objekti ynë kryesor është krijimi i policisë shumetnike në të gjitha pjesët e Kosovës, përfshirë këtu edhe Mitrovicën Veriore. Prandaj, në strukturat e SHPK-së duhet të përfaqësohen etnitë e të gjitha komuniteteve. Në Vushtrri është një shkollë policore në të cilën duhet të diplomojnë të gjithë pjesëtarët e SHPK-së. Më 15 janar 2003, 10 serbë të Kosovës dhe 10 shqiptarë të Kosovës iu nënshtroan një trajnimi intensiv tetëjavor për t'u bërë instruktorë të SHPK-së. Më 20 janar 2003, 40 serbë të Kosovës, 50 shqiptarë të Kosovës dhe 10 pjesëtarë të minoriteteve iu nënshtroan një kursi trajnues dymbëdhjetëjavor. Të rekrutuarit në SHPK do të trajnohen së bashku dhe do të punojnë tok si policë.

Krijimi i shumetnicitetit në sistemin juridik

Për vendosjen e sigurisë së shoqërisë dhe të pushtetit legjitim është me rëndësi edhe krijimi i një sistemi shumetnik juridik. Me emërimet e fundit të 13 gjykatësve dhe prokurorëve të komunitetit serbë, sistemi juridik në Kosovë tani është bërë një shërbim i mirëfillët shumetnik. Në sistemin juridik tani kemi gjithsej 373 zyrtarë vendorë: 326 gjykatës dhe 47

prokurorë. Kemi 336 gjykatës dhe prokurorë shqiptarë; 17 gjykatës dhe prokurorë serbë dhe 20 gjykatës e prokurorë nga minoritetet. Ata merren me 100% të rasteve civile dhe me 95% të rasteve të krimit.

UNMIK-u është i vetëdijshëm për sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi juridik në Kosovë. Aty ku jemi koshient se mund të çenohet objektiviteti i sistemit vendor juridik, UNMIK-u ka angazhuar 27 gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë që të bëjë hetime dhe ndjekje penale në mënyrë që drejtësia të mos dështojë. Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë marrin pjesë në 87 raste që përbëjnë përafërsisht 3-4% të rasteve që lypset të shqyrtohen nga gjykatat e qarkut dhe nga ato supreme. Këto raste përfshijnë krimet e luftës, krimet me motive etnike, terrorizmin/ekstremizmin, korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Shtimi i numrit të krimeve të tipit "Mafioz":

Ndonëse kemi shënuar një përparim në krijimin e një policie shumetnike dhe gjendja e sigurisë dhe ajo gjyqësore në Kosovë janë stabilizuar, unë megjithatë jam mjaft i brengosur për shtimin e numrit të krimeve të llojit "mafioz": si p.sh hedhja e bombave dhe vrasjet e organizuara. Është shënuar rritja e numrit të krimeve me motive politike. Krimet e tilla, ndikojnë negativisht në situatën e sigurisë, duke rritur kështu nivelin e frikës dhe të pasigurisë te popullata. Gjatë tre muajve të fundit kanë ndodhur së paku tetë incidente të këtij lloji, të cilat dëshmojnë për nevojën për mbrojtje më efikase të dëshmitarëve.

Unë s'do mend se po i referohem incidenteve siç ishte vrasja e liderit të AAK-së Z. Avni Elezaj dhe kryetarit të Kuvendit Komunal të Komunës të Suharekës Z. Ukë Bytyqi, që kanë ndodhur në muajin tetor të vitit të kaluar, pastaj në muajin nëntor vrasja e Z. Ibish Hotit avokat i shquar i të drejtave të njeriut, automjeti bombë që shpërtheu në lagjen Dardania në muajin dhjetor me ç'rast u lënduan 31 persona, vrasja në kohë të fundit e liderit të FARK-ut Z. Tahir Zemaj dhe dy kushërinjëve të tij, si dhe raketa e cila është gjuajtur mbremë në Selinë e Policisë Rajonale të UNMIK-ut në Pejë, që shkaktoi dëme shumë të mëdha materiale, por nuk pati të lënduar.

UNMIK-u po bën çmos që t'ju sigurojë mbrojtje adekuate të gjithë atyre të cilëve u kërcnohet rreziku. Dëshmitarët nuk do të dëshmojnë nëse i nënshtrohen kërcënimeve. Ne po kërkojmë nga komuniteti ndërkombëtar që urgjentisht të na ofrojë ndihmë me qëllim që t'i zgjerojmë programet tona ekzistuese për dëshmitarët. Ne jemi të bindur se askush nuk duhet të pengohet që të vijë në polici për shkak të frikës nga hakmarrja, dhe se sundimi i ligjit në Kosovë duhet të mbizotërojë mbi zakonet e heshtjes. Duhet të dihet mirëfilli se policia e UNMIK-ut, respektivisht policia civile ndërkombëtare si dhe Shërbimi Policor i Kosovës dhe KFOR-i janë të vetmet institucione që përkujdesen për sigurinë në Kosovë. Prandaj, nuk mund të tolerohet asnjë milici private.

Progresi në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Meqë situata e sigurisë është stabilizuar dhe krimi ndëretnik sa vjen po zvogëlohet, UNMIK-u është duke bërë përpjekje për ta luftuar krimin e organizuar, i cili mori hov gjatë periudhës kaotike të pasluftës. Në vitin 2002, policia e UNMIK-ut ka bërë një varg konfiskimesh të suksesshme të armëve, të drogës dhe të artikujve të tjerë të kontrabanduar, siç është duhani.

Një nga prioritetet e parashtruara nga komisari dhe unë është lufta kundër prostitucionit dhe trafikimit të njerëzve. Në vitin 2002, Njësia e Hetimeve për Trafikim dhe Prostitucion pranë Policisë së UNMIK-ut ka ndërmarrë 353 operacione dhe ka mbyllur 61 lokale. Shpresoj se këtë vit ne do të arrijmë më shumë. Me krijimin e kushteve të sigurta për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe me rritjen e aktiviteteve të Njesisë për Mbështetje Ligjore dhe Ndhimë Viktimave në Departamentin e Drejtësisë, ne synojmë që t'ua lehtësojmë viktimave të pambrojtura të trafikimit që të dëshmojnë në vend të sigurtë kundër liderëve të bandave dhe kështu të krijojnë kushte për dënimin e kërësve të bandave.

Ne gjithashtu kemi filluar të bëjmë arrestime të konsiderueshme lidhur me rastet e korrupsionit, siç ishte arrestimi i fundit i zyrtarëve të Agjencionit Kadastral të Komunës së Prishtinës. Ne kemi ndërmend të bëjmë edhe më shumë në këtë drejtim në vitin 2003. Ne duhet ta formojmë një njësi të veçantë kundër spekulimeve, respektivisht një njësi për inspektime financiare, në të cilën fillimisht do të punësohen 10 hetues krimi nga Guardia di Finanza nga Italia, që ka përvojë në hetime të këtilla. Ajo ka përvojë të gjatë me mafian. Ajo do të ketë autorizime të veçanta për t'i hetuar aktivitetet e insitucioneve dhe të ndërmarrjeve publike dhe për të bërë ndjekje penale në rast se zbulohen dëshmi për spekulime e falsifikime. Ne këtë drejtim, ne llogarisim edhe në ndihmën e qytetarëve të Kosovës. Ne shpresojmë se ata do të lajmërohen në polici, qoftë edhe në konfidencialitet nëse ka nevojë, dhe do të japin çfarëdo informate që mund të kenë lidhur me korrupsionin e për të cilën ata janë në dijeni.

Siç mund ta vërejmë nga shembujt e shteteve tjera, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit zgjat dhe është e ngadalshme. Në këtë luftë, Kosova ende është në një fazë fillestare. Por, tani UNMIK-u ka krijuar instrumentet e tij dhe ne jemi plotësisht të gatshëm që të luftojmë ate me vendosmëri.

Jean-Christian Cady,
Zëvendës i PSSP-së për Polici dhe Drejtësi

DEKLARATË E KUVENDIT MBI SITUATËN E SIGURISË

Kuvendi i Kosovës është fuqimisht kundër dhunës, çfarëdo krimi dhe krimi të organizuar në Kosovë dhe mbështet fuqimisht luftën e institucioneve përgjegjëse kundër krimit për krijimin e sigurisë në Kosovë për të gjithë qytetarët e saj.

Kuvendi i Kosovës është i vendosur që të bashkëpunojë me KFOR-in dhe UNMIK-un si për çështjet e sigurisë ashtu edhe për zhvillimet e tjera në Kosovë;

Kuvendi i Kosovës kërkon që së paku një herë në muaj të jetë i informuar nga institucionet përgjegjëse për qendjen e sigurisë në Kosovë;

Kuvendi kërkon dhe sugjeron që institucionet vendore të marrin sa më shumë kompetenca dhe përgjegjësi për problemet e sigurisë dhe të kenë një bashkëpunim më të madh me institucionet ndërkombëtare;

Kuvendi i Kosovës kërkon që të krijohen dhe strukturohen institucionet e rendit, mbrojtjes, drejtësisë dhe të përfaqësimit ndërkombëtar nga ana e institucioneve të

Kosovës të cilat do të jenë nën kontrollin civil;

Kuvendi i Kosovës i thërret të gjithë qytetarët që të denoncojnë krimin dhe të ndihmojnë në parandalimin dhe zbulimin e tij nëpërmjet dëshmimeve, duke konsideruar këtë si detyrë qytetare dhe nevojë jetësore individuale;

Kuvendi i Kosovës konsideron se ka edhe ndërhyrje të jashtëme në cënimin e sigurisë në Kosovë me qëllim të pengimit të zhvillimit demokratik të saj;

Kuvendi i Kosovës i fton mediat e shkruara dhe elektronike që të trajtojnë problemet e sigurisë në Kosovë me profesionalizëm, duke iu përmbajtur të dhënave, duke iukur gjuhës së urrejtjes, në mënyrë që të ndihmojnë në zbardhjen e plotë të gjendjes dhe njëherësh të ndihmojnë në formimin e opinionit pozitiv në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës,
23 janar 2003.

INICIATIVAT E FUNDIT PËR PËRKRAHJE KUVENDIT

Kuvendi miraton rregullore të re të procedurës

Në korrik të vitit 2002, kryesia e Kuvendit autorizoi komisionin për çështje Juridike, Legjislative dhe çështje të Kornizës Kushtetuese, me qëllim që ta rishqyrtojë rregulloren e përkohshme të procedurës së Kuvendit. Nën udhëheqjen e Prof. Arsim Bajramit (PDK) një grup punues prej 5 deputetëve u mbledh në gjysmën e dytë të vitit 2002. Nga Instituti Demokratik Kombëtar (IDK), Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt) dhe OSBE-ja u kërkua që të japin këshilla për disa çështje të veçanta, ndërsa anëtarët e grupit punues i kanë përfshirë në tekst mendimet e tyre edhe për ca çështje të tjera. Prej 3 deri me 5 janar të vitit 2003, kryesia e Kuvendit organizoi një konsultë për ta kompletuar rregulloren e rishqyruar të përkohshme të procedurës, duke u mbështetur në propozimet e grupit punues. Drafti i fundit me amendamente shtesë u aprovua në mbledhjen plenare të Kuvendit, më 9 janar 2003. Janë paraparë edhe konsultime me PSSP-ën lidhur me disa çështje të veçanta.

Komisioni për Barazi Gjinore shqyrton ligjin për të drejta të barabarta

Prej 3 deri më 7 shkurt 2003, janë bërë një varg konsultimesh nga komisioni për Barazi Gjinore në Kuvend, me qëllim që të kërkohet mbështetje nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare në përpilimin e ligjit për të drejta të barabarta gjinore në Kosovë. UNIFEM-i, FES-i, NDI-ja, World Learning Star Network dhe OSBE-ja iu përgjigjën pozitivisht kësaj kërkesë. Ligji i përgjithshëm anti-diskriminues, i cili aktualisht është nën shqyrtim në Zyrën e kryeministrit, do të përqëndrohet në parandalimin dhe luftimin e çdo lloji diskriminimi në sferën e punësimit, kualifikimit profesional, mbrojtjes sociale, shkollimit, dhe sferave tjera. Veç kësaj, ligji i përgjithshëm anti-diskriminues përcakton qartë nevojën për një ligj i cili do të promovonte të drejta të barabarta gjinore. Organizatat ndërkombëtare do ta përkrahin komisionin për Çështje Gjinore duke i siguruar atij materialet e përkthyer të ligjeve mbi barazinë gjinore të shteteve të Evropës, duke i ofruar këshilla për rishqyrtimin e projektligjeve nga perspektiva e barazisë gjinore, konsultime për planifikimin e buxhetit nga perspektiva e gjinive, konsultime mbi legjislacionin ekzistues në sferën e dhunës në familje, kundër trafikimit të njerëzve dhe për të drejtat e femrave.

Po hartohet ligji mbi lirinë e informimit

Pas disa konsultimeve me analistë politik, me shoqërinë civile dhe politikanët e Kosovës, Zyra e kryeministrit po e shqyrton "Ligjin mbi lirinë e informimit" që do të paraqitet Kuvendit gjatë muajit mars 2003. Ligji siguron të drejtën për të siguruar informata sa më të hollësishme nga institucionet vendore të Kosovës në përputhje me interesat e publikut. Qasja në informatat publike ka për qëllim që të

kontribuojë për një transparencë dhe përgjegjësi më të madhe të institucioneve të Kosovës. Si pjesë e programit të qeverisjes së mirë, NDI-ja ka paraparë përkrahjen e Kuvendit në diskutimin, aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të propozuar.

Agjencia Evropiane për Rindërtim përkrah procesin legjislativ

Më 28 janar 2003 kryeministri dhe Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) ia parashtruan qeverisë programin e AER-it për mbështetje në fushën e legjislacionit. Projekti do të përqëndrohet në harmonizimin e legjislacionit në Kosovë me "acquis communautaire" të Unionit Evropian si dhe në rritjen e kapacitetit lokal të çështjeve legjislative, duke përfshirë këtu edhe problemet e përkthimit. GTZ nga Gjermania është zgjedhur si partner implementues në procedurën e tenderit. Lideri i ekipit të GTZ-së është nga Sllovenia. Si pjesë mbështetëse e procesit legjislativ, AER-i parashih që programi për përkrahjen e Kuvendit të Kosovës, të fillojë diku kah mesi i vitit 2003.

Seminar mbi metodologjinë e hulumtimit dhe mbledhjen e të dhënave

Më 24-26 shkurt 2003, FES-i dhe OSBE-ja organizuan një seminar mbi metodat e hulumtimit dhe të mbledhjes së të dhënave për komisionet e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, Bujqësisë, Shëndetësisë, Punës, Mirëqenies Sociale dhe Shërbimeve Publike. Seminari synon t'i risë aftësitë e deputetëve që të bëjnë hulumtime të cilat janë me interes dhe me rëndësi për të ardhmen e shërbimeve shoqërore, të mjedisit dhe të shërbimeve legjislative. Institucionet të ndryshme për hulumtime të Kosovës, duke përfshirë RIINVESTI-n, Qendrën për Studime Politike dhe Sociale të Universitetit të Prishtinës, Institutin e Kosovës për Kërkime Politike dhe Zhvillim (KIPRED), Institutin e Kosovës për Shoqëri Demokratike (KIDS), Qendrën Rajonale për

Çështje të Mjedisit për Evropën Qëndrore dhe Lindore, u kanë ofruar shërbimet e tyre deputetëve.

Një vizitë zyrtare e stafit të lartë të Kuvendit në Bruksel dhe Paris

Prej 28 janarit deri më 6 shkurt 2003 nëpunësit e lartë të shërbimit civil të Kuvendit bënë një vizitë zyrtare në Bruksel dhe Paris. Delegacioni është udhëhequr nga Z. Isuf Demaj, sekretar në Kuvendin e Kosovës, përfshirë këtu edhe Z. Isa Nezirin, kryesues i Departamentit të Administratës; Z. Daut Beqirin, kryesues i Departamentit për Çështje Ligjore; Znj. Natasa Pricën, kryesuese e Sekretariatit të komisioneve kryesore; Z. Sali Rexhepin, kryesues i Zyrës për parashtresa; Z. Ilaz Berishën, kryesues i shërbimit të përkthyesve dhe Z. Gazmend Kelmendin, bashkëdrejtor në Departamentin e Zgjedhjeve të OSBE-së (përkthyesit).

Delegacioni vizitoi sekretariatet e Parlamentit Rajonal të Brukselit dhe Parlamentin Federal Belg, për të njohur më për së afërmi me funksionimin e institucioneve dy gjuhëshe. Në Paris delegacioni u prit nga Kuvendi Kombëtar Francez dhe trajnimi u përqëndrua më shumë në përdorimin e procedurave të ndonjë veprimi specifik (parashtrimi i një dokumenti, përgatitja e një raporti, një amendamenti...). Kjo vizitë shumë interesante është organizuar nga sekretariati i Kuvendit me përkrahjen e zyrave të ndërlidhjes të Francës dhe Belgjikës.

Buletini javor i sekretariatit të Kuvendit

Njësia për Punë të Jashtme e Kuvendit të Kosovës është duke u marrë me marrëdhëniet e institucioneve publike, kurse në mënyrë të drejtpërdrejt bashkëpunon me Zyrën e sekretarit të Kuvendit. Një prej detyrave të saj është që të dërgojë për çdo javë buletin në 3 gjuhë duke i përfshirë kështu të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kuvend ose që kanë të bëjnë me Kuvendin, gjatë javëve në vijim. Ajo gjithashtu duhet t'i paraqesë të gjitha programet dhe rendin e ditës të mbledhjeve plenare, të kryesisë dhe këshillit dhe ka për detyrë të përcjellë veprimtarinë e Galerisë Publike gjatë mbledhjeve plenare. Për t'u përfshirë në listën e adresave elektronike të buletinit të Kuvendit, luteni që të dërgoni një email në këtë adresë: marzal@un.org

Plani kohor i aktiviteteve për mbështetje Kuvendit

Shkurt 2003

- Vizita e stafit të lartë të Kuvendit në Paris, në Kuvendin e Francës dhe në Sekretariatit e tij.
- Konsultimet mbi rregulloren e punës.
- Konsultimet me komisionin e gjinive të Kuvendit lidhur me ligjin mbi të drejtat e barabarta gjinore dhe me Zyrën e kryeministrit përkitazi me ligjin e përgjithshëm kundër diskriminimit, nga OSBE-ja, NDI-ja, FES-i dhe donatorët tjerë.
- Konsultimet me zyrat vendore mbi programet e vazhdueshme të mbështetjes, nga OSBE-ja.
- Konsultimet mbi përpilimin e fjalorit të termave parlamentare dhe juridike, nga OSBE-ja, NDI-ja, FES-i dhe Sekretariati i Kuvendit.
- Sesioni trajnues për deputetët e Kuvendit të Kosovës mbi mundësitë e hulumtimit, 24-26 shkurt, nga FES-i dhe OSBE-ja.
- Ndhima për procesin ligjvënës, nga Bearing Point/ Barents.

Mars 2003

- Sesioni trajnues për deputetët e komuniteteve tjera, nga OSBE-ja.
- Sesioni trajnues mbi raportet me votuesit, nga NDI-ja.
- Sesioni trajnues për komisionin e gjinive dhe për komisionin e Buxhetit mbi planifikimin e buxhetit nga këndvështrimi i gjinive, 14 - 16 mars, nga OSBE-ja dhe Star-network.
- Sesioni trajnues për deputetët mbi shkathtësitë e negociimit, nga KIPRED-i.
- Sesioni trajnues për stafin ligjor të Kuvendit, nga FNS.
- Sesioni trajnues për komisionin e Tregëtisë dhe të Industrisë dhe për komisionin e Financave dhe të Ekonomisë, 25 - 26 mars, nga FNS.
- Sesioni trajnues mbi rregulloren e punës, nga FNS-i dhe NDI-ja.
- Vizita e komisionit të Shërbimeve Publike dhe e komisionit të Mirëqenies Sociale në Shqipëri, nga FES-i.
- Konsultimet mbi procesin ligjvënës, nga FES-i.
- Konsultimet mbi ligjin për Lirinë e Informimit, nga NDI.
- Konsultimet mbi përpilimin e fjalorit të termave parlamentare dhe juridike, nga OSBE-ja, NDI-ja, FES-i dhe Sekretariati i Kuvendit.
- Seanca publike në komisionin e Shëndetësisë mbi ligjin mbi prodhimet farmaceutike dhe aparaturat mjekësore, nga FES-i.
- Ndhima procesit ligjvënës, nga Bearing Point/ Barents.
- Tryeza e rumbullakët "Mediat dhe Kuvendi", java e fundit e muajit mars, nga OSBE-ja.

Prill 2003

- Vizita e stafit të lartë të Kuvendit në Berlin, në Sekretariatit e Kuvendit, në Bundestag dhe FES-i.
- Sesioni trajnues mbi ligjin për Lirinë e Informimit, nga NDI-ja.
- Vizitat e komisioneve në terren, nga OSBE-ja.
- Seanca publike në komisionin e Mirëqenies Sociale lidhur me ligjin mbi skemën e ndihmës sociale dhe ligjin mbi punët themelore dhe shëndetësinë, nga FES-i.

NDI DHE KUVENDI 2003

Kevin Deveaux, NDI.

Instituti Nacional Demokratik (NDI-IND) është një OJQ me seli në Uashington e cila është duke punuar së bashku me Kosovarët për ndërtimin e demokracisë në Kosovë që nga qershori i vitit 1999. NDI është duke punuar me Deputetët e Kuvendit (DK) dhe stafin e Kuvendit qysh prej zgjedhjeve të përgjithshme të nëntorit të vitit 2001 për t'i mundësuar DK që të trajnohen për t'i përfaqësuar interesat e zgjedhësve të tyre në mënyrë sa më efikase.

Në vitin 2003, NDI do të vazhdojë me trajnime për t'i zhvilluar raportet me zgjedhësit. NDI poashtu, do të punojë me grupet parlamentare dhe komisionet e Kuvendit për të siguruar një ngritje të aftësive dhe mundësive për t'u konsultuar rregullisht me zgjedhësit në Kosovë dhe për të mundësuar zhvillimin dhe hapjen e debeteve rreth çështjeve kryesive legjislative që kanë të bëjnë me Kosovën.

Përpos kësaj, NDI është duke bashkëpunuar me Zyrën e kryeministrit, kryesinë e Kuvendit të Kosovës

dhe komisionet kryesore të Kuvendit për të zhvilluar një qeverisje të mirëfilltë legjislative. Këtu përfshihen rregullat e ndryshuara të procedurës të cilat mundësojnë që DK të jenë në gjendje ta mbajnë Qeverinë përgjegjëse për vendimet e saja dhe njëherësh ta informojnë rregullisht Qeverinë mbi opinionet dhe kërkesat e Kosovarëve. Një ligj i ri mbi Lirinë e Informimit është paraparë për t'u diskutuar në Kuvend gjatë pjesë së parë të vitit 2003. Për më tepër, gjatë këtij viti do të shtrohen edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirëfilltë legjislative.

Në fund, NDI shpreson se do të bashkëpunojë me komisionet e Kuvendit për t'i aftësuar që ta kryejnë punën e tyre në mënyrë sa më efikase, nëpërmjet bashpunimit si multi-etnik ashtu edhe multi-partiak. Njëherësh, shpresohet se edhe komisioni për Barazi Gjinore do të ketë mbështetjen për të siguruar që çështjet të cilat i preokupojnë femrat e Kosovës të adresohen dhe dëgjohen më zëshëm në parlament.

FONDACIONI FRIEDRICH NAUMANN: NJË KOMENT MBI VITIN 2002 DHE PLANET PËR VITIN 2003

Minire Çitaku, Koordinatore e projektit të FNSt për Kosovë

Pas sesionit përurues të Kuvendit të Kosovës, Fondacioni Friedrich Naumann (FNSt) filloi me përkrahjen e Kuvendin në kuadër të kornizës së Inicativës Përkrahëse të Kuvendit (ASIP-IPA).

Kur është fjala për anëtarët e zgjedhur të Kuvendit, theks i veçantë është vënë në përkrahjen e komisionit për Tregëti dhe Industri si dhe për Ekonomi dhe Financa duke mundësuar një proces të dialogimit dhe të këmbimit të përvojave në fushën e ekonomisë.

Kjo u arrit përmes aktiviteteve të ndryshme duke përfshirë puntoritë, seminarret dhe diskutimet e hapura me përfaqësuesit e organizatave të ndryshme ekonomike. Veç kësaj, është dhënë mbështetje edhe në debatin mbi rishqyrtimin e rregulloreve të punës si dhe një seri trajnimesh të cilat janë bërë me stafin që mirret me çështjet ligjore të Sekretariatit të Kuvendit.

Bazuar në konsultimet e Bazuar në konsultimet e FNSt ka vërejtur një shkëmbin të dobët të informatare brenda procesit par-

-lamentar. Në nivel të anëtarëve individual rekomandohet angazhim më i rregullt formal apo jo formal në këmbimin e pikëpamjeve në mes të deputetëve nga grupet e tjera parlamentare. Në nivel të grupeve parlamentare politike, duhet të bëhen përpjekje që të përmirësohen strukturat e brendshme të punës përmes ndarjes së punës dhe këmbimit të rregullt e të brendshëm të informatave. Në nivel të komisioneve, kontaktet e rregullta me shërbyesit civil të lartë në ministrinë përkatëse (p.sh. pjesëmarrja e ndërsjellë në mbledhje) do të shtonte mbikëqyrjen ekzekutive.

Në vitin 2003 FNSt do të dëshironte të vazhdojë punën e filluar me sukses në vitin 2002. Qëllimi FNSt në përgjithësi do të jetë transferimi i standardeve evropiane në institucionet e Kosovës, duke e përkrahur si veprimtarinë e stafit për çështje ligjore ashtu edhe të komisionit për Tregëti dhe Industri dhe Ekonomi e Financa bazuar në konceptet moderne në fushat përkatëse.

Njëherësh do të ofrohet përkrahje e mëtejshme për këmbimin e mendimeve dhe përvojave që kanë të bëjnë me rregulloren e punës.

FNSt do të bëjë çmos për të përmirësuar këmbimin e informatave në mes të UNMIK-ut dhe institucioneve vendore sikurse edhe me grupet shoqërore në mënyrë që të përshpejtohet procesi i përmbushjes së standardeve të parashtruara nga PSSP. Qëllimi i këtyre veprimeve të FNSt është që të përkrahë bartjen e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare te ato kosovare. Veç kësaj, FNSt do të ofrojë përkrahjen edhe për kërkesat tjera që do të parashtroheshin nga Kuvendi.

Njëkohësisht, do të shtohen përpjekjet për të marrë pjesë në aktivitetet e iniciativës për përkrahje të kuvendeve komunale, (IPKK-MASI). Një program i "trajnimit të trajnerëve" do të organizohet në mënyrë që të përkrahen dhe t'u jipen këshilla teknike trajnerëve lokalë në procesin e krijimit të politikave komunale.

ASI PRET ME PADURIM THEMELIMIN E INICIATIVËS SIMOTËR, MASI

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit (ASI), që lindi në dhjetor të vitit 2001, është bërë një fëmijë aq i gjallë dhe vigjilent, sa që familja e tij - gjegjësisht, agjencionet që mbështesin themelimin e institucioneve demokratike në Kosovë- vendosi që ky fëmijë duhet ta ketë edhe një motër: "MASI", "Iniciativën për Mbështetje Kuvendeve Komunale."

Hartmut Pürner, OSBE, Departamenti i Demokratizimit, Ekipi për Mbështetje Kuvendeve Komunale

hartmut.purner@omik.org

Më 27 janar dhe 10 shkurt të këtij viti u zhvilluan takimet e para përgatitore. Asociacioni i Komunave të Kosovës, Këshilli Evropian, Fondacioni Friedrich Naumann, Instituti i Kosovës për Hulumtime Politike dhe Zhvillim (KIPRED), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Zyra e PSSP-së, Programi i OKB-së për Zhvillim (UNDP), Habitati i OKB-së dhe Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) iu përgjigjën me kënaqësi ftesës së Ekipit të Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së për Mbështetje Kuvendeve Komunale. Këto organizata u mbledhën, meqë ato edhe më herët kishin rënë dakord se "MASI" duhet t'ua ofrojë të tridhjetë kuvendeve komunale të Kosovës të njëjtën ndihmë që ASI-ja ia ka ofruar Kuvendit të Kosovës.

Si koordinator ndërmjetësues i programeve të demokratizimit për mbështetje Kuvendit të Kosovës, ASI synon përfundimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Kjo është bërë dhe është duke u bërë përmes aftësimin të kuadrove, në mënyrë që sa më shpejt që të jetë e mundur të krijohet një kuvend stabil, funksional, produktiv dhe ligjvënës që vepron në harmoni me pushtetin ligjor dhe në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve. "MASI", duke bashkëpunuar me kuvendet

komunale, synon t'i realizojë të njëjtat qëllime në nivelin komunal. Grupet të cilëve do t'u ofrohet mbështetje janë zyrtarët e zgjedhur të kuvendeve komunale, kryetarët e këtyre kuvendeve, si dhe nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të tyre. Trajnimi profesional i nëpunësve civilë komunalë është përgjegjësi ligjore e Ministrisë së Shërbimeve Publike, si njëra nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes.

Njëherësh, për krijimin e strukturave të brendshme dhe të mjetëve për bashkëpunim ndërmjet partnerëve si model duhet të merren shembujt e suksesshëm të iniciativës më të vjetër simotër. Anëtarët e Iniciativës për Mbështetje Kuvendeve Komunale, për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta, duhet t'i bashkojnë kapacitetet e tyre. Sikurse ASI, edhe MASI do ta përqëndrojë punën e saj në promovimin e një kulture demokratike politike duke u bazuar në njohjen dhe respektimin e rregulloreve demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësitë ndaj popullit.

Pikërisht tani është momenti i volitshëm që të bashkohemi dhe përmes përpjekjeve të përbashkëta, t'u ofrojmë përkrahje kuvendeve komunale të Kosovës në kryerjen e detyrave të tyre. Para nesh kemi planin katërvjeçar për mbështetje kuvendeve të sapo-

formuara komunale, që do të jetë me rëndësi jetike për themelimin e strukturave të mirëfillta funksionale dhe demokratike në nivelin komunal. Njëkohësisht, shkalla e angazhimit të burimeve të jashtme kadrovike dhe financiare në Kosovë është në rënie. Nga njëra anë, MASI synon t'i shtojë përpjekjet për koordinimin e programeve për trajnim, ndërsa nga ana tjetër, përmes këtyre përpjekjeve përipiqet t'i arrijë efektet që do të ishin të dobishme për të dy palët. Kështu, përderisa tërësia e burimeve dhe e financave që i dedikohen aftësimin të kuadrove mund të pakësohet, MASI mund të jetë mjet që përkundër këtyre kufizimeve, do të jetë në gjendje të ofrojë cilësinë e njëjtë të trajnimit të klientëve të përbashkët, gjegjësisht të anëtarëve të kuvendeve komunale të Kosovës.

Lista e pjesëmarrësve të ardhshëm tanimë është mjaft impresive, ndërsa numri i pjesëmarrësve që figurojnë në këtë listë mund të rritet në të ardhmen. Sikurse ASI, edhe MASI do të jetë e hapur ndaj të gjitha agjencioneve që parashikojnë të ofrojnë kontributin e tyre në aftësimin e kuadrove të kuvendeve komunale të Kosovës. Partnerët aktual presin me padurim që t'u dëshirojnë mirëseardhje pjesëmarrësve tjerë në radhët e tyre. Tanimë janë ofruar idetë e

para për bashkëpunim. Asociacioni i Komunave të Kosovës gjatë vitit 2003 do të vazhdojë ta konsolidojnë vetëqeverisjen komunale në Kosovë. Këshilli Evropian dhe Asociacioni i Agjencive për Demokraci Lokale në shkurt të vitit 2003 do ta themelojnë një Agjenci për Demokraci Lokale (ADL) në Kosovë në Gjilan. Friedrich Naumann Stiftung ka hartuar një program trajnimi, që përbëhet nga 10 njësi trajnimi dhe që do të realizohet në bashkëpunim me OSBE-në. OJQ-ja kosovare KIPRED do të zhvillojë trajnime për partitë politike në nivelin qendror dhe në atë komunal. Përderisa grupet e para të caktuara për trajnim janë partitë politike, KIPRED-i ka vënë në dukje se partitë politike nuk duhet të përgjashtohen nga veprimtarit politike të kuvendeve. NDI-ja do të angazhohet për përmirësimin e raporteve ndërmjet partive dhe elektoratit dhe do të mbajë sesione trajnimi mbi formulimin e politikave, si në nivelin e kuvendit qendror ashtu edhe në atë të kuvendeve komunale.

UNDP-ja dhe Habitat i OKB-së janë përqëndruar në trajnimin e nëpunësve civilë dhe për subjekt homolog e kanë Ministrinë e Shërbimeve Civile. Ndërkaq, këto organizata reagon pozitivisht ndaj propozimit mbi shpërndarjen e përbajtjeve të programeve

të trajnimeve nëpunësve civilë dhe anëtarëve të kuvendeve komunale, për t'u siguruar që kjo përbajtje të shfrytëzohet për formulim efektiv të politikave dhe për mbikëqyrje të administratës. USAID-i, njëri ndër partnerët e Ministrisë së Shërbimeve Publike, hë për hë nuk është duke mbajtur ndonjë trajnim për kuvendet komunale, por megjithatë, është duke hartuar një projekt katërvjeçar që mund të fillojë diku nga fundi i vitit 2003 apo fillimi i vitit 2004.

Ekipi i OSBE-së për Mbështetje Kuvendeve Komunale do ta vazhdojë veprimtarinë e tij për aftësimin e kuadrove, edhe pse projektet e programit të tij "Pakoja për nismën e aktiviteteve të kuvendeve komunale" (MASK), që me një emër është quajtur ReGoCip ("Responsible Government and Citizen Participation- Qeveria e Përgjegjshme dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve), projektet e hartuara nga zyrat e OSBE-së anëmbanë Kosovës, dhe aktivitetet tjera të Ekipit të komuniteteve etnike dhe të atij për mbështetje pjesëmarrjes së qytetarëve, janë duke u mbajtur që nga nëntori i vitit 2002.

MASI duhet t'i bëjë hapat e parë në pranverë të këtij viti. Shpresohet shumë se kjo iniciativë do të jetë po aq energjike sa edhe iniciativa simotër e saj për mbështetje Kuvendit të Kosovës.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si kordinatore e programeve për demokratizim ndërmjet agjensive për të përkrahur Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për përkrahjen e Kuvendit (ASI) tenton forcimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës me zhvillimin e shkathëtësive për të u bërë sa më shpejt një kuvend stabil, funksional dhe liqdhënës që vepron në harmoni me mbizotërimin e ligjit dhe në emer të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve baraz.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë që të i bëjnë burimet në një vend për përparimin e këtij qëllimi. ASI do të punoj në harmoni me principin se përgjegjësia për punën e vërtet të Kuvendit është dhe duhet të jetë përgjegjësi e anëtarëve të Kuvendit.

Puna e ASI-t do të përqendrohet në kulturen demokratike dhe politike duke u bazuar në njohuritë dhe rrespektin e rregullave demokratike të procedurës, transparencë dhe përgjegjësinë ndaj popullit dhe në zbatimin e rendit legjislativ, mbikqyrjen e ekzekutivit dhe në rrespektin për shumë gjuhët e Kuvendit.

Si një kordinatore ndërmjet agjensioneve për programet e demokratizimit për të përkrahur Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmesë konferencave dhe trajnimeve, punëtorive me komitetet, ndihmes teknike për Kryesinë, për krerët e komiteteve dhe për delegatët e Kuvendit, përmesë vizitave në vendet tjera dhe në parlamente tjera, trajnime për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Puna e këshilltarëve për Kuvendin dhe komitetet është gjithëashtu pjesë e kordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit të ASI-t deri më tash janë:

Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich Ebert Stiftung FES), Fondacioni Fridrih Nauman (Friedrich Naumann Stiftung FNS), Agjensioni SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtarë (U.S. Agency for International Development USAID) në bashkëpunim me Institutin kombëtarë demokratik (National Democratic Institute NDI), Departamenti për Demokratizim i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrave përfaqësuese në Prishtinë të vendeve: SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermanisë, Belgjikës, Holandë, Zvicrës, Italisë, Austrisë shtylla e BE dhe Agjensioni europian për rindërtim (EAR), Programi për zhvillim i Kombeve të bashkuara (UNDP), në bashkëpunim me Union ndërparlamentarë dhe me Projektin për praktika parlamentare lindje-perendim nga Holanda (East-West Parliamentary Practice Project EWPPP)



Prishtinë, Beograd 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.de-vrieze@omik.org

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, i përkasin vetem atyre dhe jodomsdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t